



Prof. Dr. Etleva Delia
edelia@ubt.edu.al

Prof. Dr. Etleva Delia është diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, Dega Zootekni, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në vitin 1991. Qysh prej këtij viti dhe në vazhdim ajo është pedagoge në grupin mësimor-kërkimor "*Të Ushqyerit e Kafshëve*". Ajo përfundoi studimet e Ph.D në vitin 2002, si rrjedhojë e një bashkëpunimi me Institut für Tierernährung, Freie Universität, Berlin, Gjermani. Prej vitit 2012, mban titullin "Profesor". Në periudhën 2010-2016 ka mbajtur detyrën e Zv. Dekanes për Shkencën dhe Drejtor i Shkollës së Doktoratës në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit. Aktualisht është anëtare e Senatit Akademik të UBT-së.

Prof. Delia ka marrë pjesë dhe ka drejtuar 11 projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të financuara nga Qeveria Shqiptare, (AKTI), projekt Tempus, si dhe projekte me bashkëpunim bilateral me Slloveninë dhe Austrinë.

Puna kërkimore-shkencore e saj është mbështetur nga Ambasada gjermane përmes programit (DAAD) në periudhën 2003, 2006, 2009.

Ajo është autore dhe bashkëautore në 30 artikuj shkencorë dhe ka marrë pjesë me punim në më shumë se 55 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Ajo është autore e parë në kapitullin "Efficiency of Probiotics in Farm Animals. Probiotic in Animals, edited by Everlon Cid Rigobelo, Chapter 11, ISBN: 978-953-51-00777-4. Pg. 247-272. <http://dx.doi.org/10.5772/3319>.

Aktualisht interesat e saj kërkimore janë të fokusuara në rolin e aditivëve ushqimorë biologjikë si probiotikët, prebiotikët, sinbiotikët dhe enzimët në të ushqyerit e kafshëve monogastrike.

Prof. Dr. Etleva Delia is graduated on the Faculty of Veterinary Medicine, Department of Animal Science, at the Agricultural University of Tirana, 1991. Since this year and onwards she is a lecturer of Animal Nutrition. She completed her Ph.D. studies in 2002, as a result of a collaboration with the Institute für Tierernährung, Freie Universität, Berlin, Germany. Since 2012, she holds the title "Full Professor".

From 2010-2016 she held the position of Vice-Dean for Science and Director of Doctorate School at the Faculty of Agriculture and Environment. She is currently a member of the Academic Senate of AUT. Prof. Delia has been team leader or member in 11 national and international scientific projects funded by the Albanian Government, (NASRI), Tempus project, as well as bilateral projects with Slovenian and Austrian universities.

Her research work was supported by the German Embassy through the program (DAAD) in the period 2003, 2006, 2009.

She is the author and co-author of 30 scientific papers and has participated in more than 55 national and international conferences. She is the first author of the chapter "Efficiency of

Probiotics in Farm Animals. Probiotic in Animals, edited by Everlon Cid Rigobelo, Chapter 11, ISBN: 978-953-51-00777-4. Pg. 247-272. [http // dx.doi.org / 10.5772 / 3319](http://dx.doi.org/10.5772/3319).

Currently, her research interests are focused on the role of feed additives such as: probiotics, prebiotics, synbiotics and enzymes in non ruminant's animal nutrition